



Lediana

Një brez i ri artizanësh po ringjallin artet dhe zejjet në Berat

“Të gjithë habiten kur dëgjojnë që jam nga Tirana, por e shijoj jetën këtu në Berat – dhe mbi të gjitha, bëj punën që kam ëndërruar,” shpjegon Lediana, teksa tregon dyqanin e saj me artikuj zejtarie në lagjen historike Mangalem në Berat.

Ledian 23-vjeçare duket sikur nuk i shkon hapja e një dyqani zejtarie në Berat: lindur dhe rritur në Tiranë, ka studiuar biznes dhe ekonomi në Universitetin e Tiranës dhe kishte në plan të fillonte karrierën profesionale në kryeqytet.

“Gjithmonë kam pasur pasion artin. Xhaxhai im ka qenë piktor por nuk jetonte dot duke shitur pikturat. Prindërit e mi

A new generation of artisans are reviving arts and crafts in Berat

“Everyone raises an eyebrow when they hear I am from Tirana, but I enjoy life here in Berat - and above all, I’ve got my dream job”, explains Lediana, proudly showing off her cozy arts and craft shop in the historic Mangalem neighborhood of Berat.

23-year-old Lediana seems like an unlikely fit to open an artisan’s shop in Berat: born and raised in Tirana, she studied business and economics at the University of Tirana, and was set to launch her professional career in the capital.

“I have always had a passion for the arts. My uncle was a painter, but he could not

nuk donin të bija në të njëjtin çark dhe më nxitën të ndiqja universitetin me shpresë se do të gjeja një punë të qëndrueshme,” pohon Lediana.

Megjithatë, Lediana e pati të vështirë të gjente punë në Tiranë – kishte shumë pak vende pune dhe shumë individë me kualifikime të ngjashme si të saj. Pas takimit me artistin drupunues Krenar Koroni, i cili tani është bashkëshorti dhe partneri i saj në biznes, rizbuloi pasionin për artin. “Fillova të përdorja teknikën e pirografisë, e cila është një mënyrë për të stolitur drurin ose lëkurën duke djegur një dizajn në sipërfaqe me një majë të nxehtë metalike, për të dekoruar varëse çelësash në druri,” tregon ajo. Pak kohë më pas, Lediana mori pjesë në panairin e parë të artizanatit me Qendrën Artizanale Margarita, ku varëset e çelësave ishin një sukses i menjëhershëm. Lediana i shiti të gjitha produktet dhe madje mori edhe porosinë e parë nga një tregtar nga Saranda. Kjo përvojë e nxiti që të fillonte aventurën e vet të biznesit: në shtator 2016, Lediana hapi dyqanin e vet zejtar-artistik në Berat.

Qendra artizanale Margarita, misioni i së cilës është të ekspozojë pasurinë dhe traditën e jashtëzakonshme artizanale të Beratit, është një faktor jetësor në suksesin e Ledianës. Pas pjesëmarrjes në garën për çmimin Risi Turistike, RisiAlbania e mbështeti shoqatën për të zhvilluar një plan biznesi të plotë 3-vjeçar. Kjo e ndihmoi shoqatën të vepronte si biznes, të eksploronte mënyra për të rritur cilësinë e produkteve dhe për të gjetur kanale të reja shitjesh.

make a living out of selling his paintings. My parents did not want me to fall into the same trap, so they encouraged me to pursue a university education with the hope that I will find stable employment”, states Lediana.

But Lediana struggled to find a job in Tirana - there were so few jobs and plenty of people with similar qualifications to hers. After meeting the woodcraft artist Krenar Koroni, who is now her husband and business partner, she rediscovered her passion for the arts. “I started using the pyrography technique, which is a way to adorn wood or leather by burning a design on the surface with a heated metallic point, to decorate wooden key chains.” Soon after, Lediana participated in her first artisan’s fair with the Margarita Artisanal Center, where her key chains were an instant success. Lediana sold all her products and even got her very first order from a trader in Saranda. This experience emboldened her to embark on her own business adventure: in September 2016, Lediana opened her very own arts and craft shop in Berat.



Lediana ilustron se si shoqata ka transformuar 25 anëtarët e saj. Duke marrë pjesë në panairë nëpërmjet shoqatës, Lediana është ekspozuar ndaj një numri shitësish dhe ka mësuar se çfarë kërkohet vërtet nga tregu. Po ashtu ka mundur të marrë pjesë në disa trajnime dhe seminare që kanë rritur më tej cilësinë e punës së saj. Kjo i ka dhënë besimin për të hapur biznesin e vet, duke kanalizuar pasionin e saj në një shteg të pazakontë karriere – një histori vërtet frymëzuese për gratë kudo në Shqipëri.

The Artisanal Center Margarita, whose mission is to showcase Berat's extraordinary artisanal richness and tradition, is a vital factor in Lediana's success. After participating in the Risi Turistike Award competition, RisiAlbania supported the association in developing a thorough 3-year business plan. This helped the association to become more business savvy, explore ways to enhance the quality of its products and find new sales channels.



Lediana illustrates how transformative the association is to its XX members. By participating in fairs through the association, Lediana was exposed to different sellers and got to know what is really demanded by the market. She was also able to participate in various workshops and trainings, which boosted the quality of her work. This provided her with the confidence to open up her own business, channeling her passion into an unconventional career path – a truly inspiring story to women across Albania.